



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

Nr. Prot. 480 Dt 15.03.2021

NJOFTIM – ZGJEDHJET E STUDENTËVE 2021

Në zbatim të Statutit të Universitetit dhe Rregullores për zgjedhjet e studentëve, themelimin dhe punën e Parlamentit Studentor dhe Këshillat e Studentëve në Universitetin "Isa Boletini", në Mitrovicë, Këshilli Drejtues i Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, në mbledhjen e mbajtur më 15.3.2021, ka marrë vendim mbi shpalljen e zgjedhjeve të studentëve të Universitetit, të cilat do të mbahen më **12.4.2021**.

Universiteti i Mitrovicës inkurajon të gjithë studentët e universitetit, që të marrin pjesë në zgjedhje dhe të votojnë kandidatët, që ata mendojnë, se më së miri do t'i përfaqësojnë interesat e tyre në njësitë akademike përkatëse dhe në Senatin e Universitetit.

Universiteti inkurajon kandidimin e studentëve më të mirë dhe të gjitha Organizatat Studentore (OS) të cilat në programet e tyre nuk kanë agjendë politike, fetare dhe racore, që denjësisht t'i përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e studentëve.

Organizatat studentore, të interesuara për të marr pjesë në zgjedhjet studentore, për Këshilla të studentëve të fakulteteve dhe për Parlament të studentëve, do të certifikohen nga Komisioni Qendror Zgjedhor më **26.03.2021**. Paraprakisht, OS duhet të jenë të regjistruara në Ministrinë e Administratës Publike, konform Ligjit për Lirinë e Asocimit në Organizatat Joqeveritare. Me rastin e aplikimit për certifikim në KQZ, organizatat studentore duhet të dorëzojnë edhe Listën e deklarimit të studentëve, në mbështetje për certifikimin e Organizatës studentore për zgjedhjet e studentëve 2021, me më së paku 50 nënshkrime, për certifikim për zgjedhjet për Këshill të studentëve dhe me më së paku 150 nënshkrime, për certifikim për zgjedhjet për Parlament të studentëve.

Për informata më të hollësishme lidhur me mbarëvajtjen e procesit zgjedhor klikoni linkun <http://www.umib.net> zgjedhjetstudentore2021



Rr. Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; info@umib.net; Tel: +383-28/535725/515516 – lokali 1